



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVË DHE REKREACIONIT

Data 20.12.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje karburant e ndarë në lote” si më poshtë:

Loti I. “Blerje Naftë”,

Lotin II. “Blerje Benzine”,

Loti III. “Blerje Gaz”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

(FPP):

09134000- 7 _Naftë ,

09132100-4)_Benzine pa plumb

09121200 - 5 _Gaz i rrjetit Publik

VLERA E FONDIT LIMIT:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

Fondi limit i Marrëveshjes Kuadër për 24 (njëzet e katër) muaj vite në total është:

109.967.924 (njëqind e nëntëmilion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e katër) **Lekë pa TVSH ose 1.066.925** (një milion e e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) **Euro pa TVSH.** (Kursi i këmbimit referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë me datë 19.12.2023 është 103.07).

- **Për Lotin 1 “Blerje Naftë”,** me afat të marrëveshjes kuadër **24 (njëzet e katër) muaj,** me fond limit të marrëveshjes kuadër: **90.920.160 (nëntëdhjetë milion e nëntëqind e njëzet mijë e njëqind e gjashtë mijë)** lekë pa TVSH, ose **882.121 (tetëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëzet e një)** Euro pa TVSH (Kursi i këmbimit referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë me datë 19.12.2023 është 103.07).

- **Për Lotin 2 : “Blerje Benzinë”**, me afat të marrëveshjes kuadër **24 (njëzet e katër) muaj**, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **17.669.204** (shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e katër) **lekë pa TVSH**, ose **171.429 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e njëzet e nëntë) Euro pa TVSH** (Kursi i këmbimit referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë me datë 19.12.2023 është 103.07).
- **Për Lotin 3: “Blerje Gaz”**, me afat të marrëveshjes kuadër **24 (njëzet e katër) muaj**, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **1,378,560** (një milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) **lekë pa TVSH**, ose **13.375** (trembëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH (Kursi i këmbimit referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë me datë 19.12.2023 është 103.07).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **“Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit”** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti I. **“Blerje nafte”**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *“...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës 1.818.403,2 (një milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tre presje dy) lekë ose ose 17.642,41 (shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e dymijë presje dyzet e një) euro, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: *“...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”*

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. 3. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 9001:2015 (e vlefshme) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e cila të përfshijë objektin e prokurimit. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.).

2.1.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 14001 (e vlefshme) mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” e cila të përfshijë objektin e prokurimit. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “*Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit*”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të këtij loti**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa vlera e fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në

percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Kërkohet vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, në një vlerë jo më të vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të këtij loti, referuar nenin 43 pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi kjo është një procedurë e **Hapur- mbi kufirin e lartë monetar**, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c” të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

Shënim:

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare, sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Përcaktimi sa më sipër bëhet në mbështetje të nenit 42, Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti** dhe konkretisht jo më të vogël se vlera: **36.368.064 (tridhjetë e gjashtëmilion e treqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa tvsh ose 352.848 (treqind e pesëdhjetë e dymijë e tetëqind e dyzet e tetë) Euro pa TVSH** (Kursi i këmbimit referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë me datë 19.12.2023 është 103.07). Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të

deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Në rast se operatori ekonomik ofertues merr pjesë në dy ose tre lote së bashku, vlera e furnizimeve të ngjashme, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e shumës së loteve ku oferton, të marra së bashku.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Subjekti ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në Bashkinë Tiranë. Subjekti duhet të ketë minimalisht 7 stacione të shitjes me pakicë të karburanteve, vërtetuar me dokumentacionin: **(a)** Certifikatë pronësie/kontratë noteriale qiraje ose huaje të ambientit, **(b)** Ekstrakt e QKB-së ku të jenë pasqyruar stacionet e furnizimit, **(c)** Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK); Certifikate e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH; Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributoret e shitje me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas tabelës me poshtëme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1			

**Edhe në rast se ofertuesi do të konkurojë për dy ose tre lote, për të gjitha lotet duhet të ketë minimalisht 7 stacione”.*

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, pika 5/a/ç dhe pika 8, “Kërkesa të veçanta të kontratave të mallrave” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurrohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Ky kriter është vendosur për të evituar koston e shtuar për Autoritetin Kontraktor në lidhje me procesin e furnizimit

të automjeteve me karburant dhe për këtë asrye janë kërkuar 9 stacione për shitjen e karburantit brenda Bashkisë Tiranë të cilat janë të domosdoshme referuar dhe objekteve në administrim të APR-së e cila ka një shtrirje të gjërë brenda Bashkisë së Tiranës ku Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave ka 13 njësi administrative, të cilat zënë pjesën më të madhe të fondit pyjor, të cilat shtrihen deri në kufi me Bashkitë e tjera.

Nëpërmjet kërkesës për 7 stacione furnizimi, Autoriteti Kontraktor synon të ulë koston e furnizimit të automjeteve, sipas parimit të ekonomisë së kursimit, për shkak se automjetet lëvizin në zona të ndryshme të Bashkisë Tiranë dhe në rast se këto stacione do të ishin më larg, kjo do të ndikonte direkt në rritjen e koston, pasi mjetet do të harxhonin më tepër karburant për shkak të itinerarit që do të përshkojnë. Gjithashtu, nëpërmjet këtij kriteri, synohet edhe kursimi i kohës që do të duhet për të realizuar procesin e furnizimit në stacionet e karburantit.

2.3.3 Të gjitha stacionet e furnizimit me karburant detyrimisht duhet të mbajnë të njëjtën Logo, cka do jetë e vërtetuar me një deklaratë nga subjekti ofertues, ku të paraqitet dhe logo e shoqërisë e cila do të jetë në këto stacione. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve, stacionet e furnizimit duhet të përmbajnë Logo-të e shoqërive pjesë të bashkimit, cka do jetë e vërtetuar me një deklaratë nga shoqëritë përkatëse, ku të paraqitet dhe logo e tyre.

Argumentimi: Kriteri sa më sipër bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" si dhe referuar përcaktimeve të nenit 40, pika 8 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Gjithashtu kërkesa është vendosur në përputhje me Ligjin 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim teknik të leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK, Leje mjedisore të tipit B, të leshuar nga QKL, Akt-Teknik të leshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi të leshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregtimit me shumicë që vërteton kapacitetet depozituese lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktore.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 "Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel", VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie të licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 429, datë 26.6.2019 për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)", Urdhër Nr. 6, datë. 09.01.2015 "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe Nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse, Urdhërit nr 315, date 24.08.2017 "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitetet në fushën e përpunimit, transportimit dhe

tregëtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj”, Ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “për lejet e Mjedisit”, të ndryshuar

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 autobotë të transportit të lëndëve të rrezikshme (naftë), kapacitet mbajtës deri në 1,000 litra duhet të jenë për transport naftë.

Për të provuar disponimin e autobotit Operatori ekonomik duhet të paraqesë për autobotin dokumentacionin që përbëhet nga: **(a)** Leje qarkullimi, **(b)** Certifikatën e kontrollit teknik, **(c)** Policë sigurimi, **(d)** Certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, **(dh)** Pasaportën e mjetit lidhur me kapacitetin mbajtës. Autoboti duhet të jetë i kalibruar nga DPM.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për plotesimin e kriterit sipas pikes 2.3.5, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit “Procedure e Hapur mbi kufirin e larte monetar– Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 5/ç “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit “mallra” duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të automjetetit për transportin e karburantit, por pa përcaktuar se si disponohen këto

automjete dhe meqënëse këto mjete qarkullojnë në territorin shqiptar, ju referuam nenit 81, 83 e 178 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

2.3.6 Subjekti ofertues duhet të paraqese një vertetim të leshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesive përgjatë vitit të fundit 2023.

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës" si dhe Ligjit 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Shtrirja kohore ka të bëjë me faktin e kualifikimit të OE të cilët operojnë në treg me një performancë të mirë në funksion të mbajtjes së cilësisë sipas standarteve zyrtare të kërkuara për mallin objekt kontrate për një shtrirje kohore 1 vit.*

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçencë VIII.1.A për tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil Diesel 10 ppm) leshuar nga QKL (Qendra Kombëtare e Licensimit) ose Autorizim apo Licensë për tregtim karburantesh (Gazoil Diesel 10 ppm) për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e karburantit të llojit: Gazoil Diesel 10 ppm e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve duhet të jenë të rregjistruar në një nga regjistrat profesionalë për zbatimin e objektit të kontratës.

Gjithashtu në nenin 4 të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar përcaktohet se:

” Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme.”.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e tregtimit të karburanteve janë të detyruar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë të rregjistruar në rregjistrat përkatës profesionale.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 970, datë 2.12.2015 *”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”*, i ndryshuar, ku në pikën I/2/a dhe në pikën II/1 përcaktohet se:

”I. PROCEDURA E DHËNIES SË LICEN-CAVE TË TREGTIMIT ME SHUMICË TË NAFTËS BRUTO DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ

1. Veprimtaria e tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj bëhet vetëm nga shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqërive aksionare, pasi të jenë pajisur me “Licencë tregtimi” nga Qendra Kombëtare e Licencimit (OKL).

2. Licenca “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse”, me kodin VIII.1.A, përfshin tri llojet e veprimtarive, si më poshtë vijon:

a) Lloji “A”: tregtimi me shumicë i naftës bruto e nënprodukteve të saj të kategorive 0, II, III, IV e V, me përjashtim të nënprodukteve që destinohen për furnizimin e mjeteve të fluturimit ajror;

II. PROCEDURA PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR TREGTIMIN ME PAKICË TË KARBURANTEVE, GAZIT TË LËNG-SHËM TË NAFTËS, PËR AUTOMJETET, VAJRAVE LUBRIFIKANTE DHE LËNDËVE DJEGËSE PËR PËRDORIM NGA KON-SUMATORËT FUNDORË

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

a) Ministri që mbulon veprimtarinë e transportit rrugor, kur stacioni i karburanteve do të ndërtohet në autostradë;

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.”.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 *”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (OKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”*, i ndryshuar, ku në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

”2. Në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet OKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;

b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;

c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;

ç) Afatet e vlefshmërisë së licencave;

- d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e QKL-së;
- dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet QKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;
- e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që QKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;
- ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;
- f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;
- g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.

Aneksi I

FUSHA VIII

INDUSTRI DHE SHËRBIME TË TJERA

KATEGORIA VIII.1

PRODHIMI, DEPOZITIMI, TRANSPORTI, PËRDORIMI DHE/OSE TREGETIMI I PRODUKTEVE DHE/OSE LENDEVE A PAJISJEVE TË TJERA ME RREZIKSHMËRI

1. Veprimtaritë e “Prodhimit, depozitimit, transportit, përdorimit dhe/ose tregimit të produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri” bëjnë pjesë në kategorinë VIII.1 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”..
2. Kategoria e këtyre veprimtarive ndahet në tre nënkategori si vijon:
- a) “Tregtimi me shumice i naftes, gazit, nenprodukteve perfs hire ato bio si dhe lendet djegese” me kodin VIII.1.A
- b) “Veprimtari të lidhura me substancat dhe preparatet kimike me rrezikshmeri” me kodin VIII.1.B
- c) “Veprimtari të lidhura me burime me rrezatim jonizues” me kodin VIII.1.C
3. Tregtia me pakicë licencohet sipas legjislacionit në fuqi. Veprimtari të tjera specifike me këto lëndë nuk licencohen.
4. Kriteret e posaçme të licencimit si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për nënkategorinë VIII.1.A jepen në tabelën 1 më poshtë.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, gjykojmë se operatorët ekonomik ofertues të cilët tregtojnë karburante të llojit: Gazoil Diesel 10 ppm, duhet që të jenë të pajisur me licensë VIII.1.A per tregtim karburantesh të llojit III/A ose me licensë apo autorizim të tregtimit pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit “Procedure e Hapur mbi kufirin e larte monetar– Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/a “Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

”5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose;”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me licensa profesionale për furnizimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin konkret meqënëse edhe ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe

nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar nuk lejon që të ushtrohet aktiviteti i tregimit të karburanteve pa licensë profesionale atëherë njësia e prokurimit vendosi hartimin dhe vendosjen e këtij kriteri kualifikues.

2.3.8 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me karte elektronike të personalizuar me targon e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasine e litrave të ndodhura në karten elektronike të personalizuar me targon e mjetit, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Kartat elektronike duhet të jenë pa afat skadencë.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepermjet karteve elektronike të personalizuar, sipas nevojës të Autoritetit Kontraktor. Kartat elektronike të jenë pa skadencë gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër.
- Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 **“Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme”**, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojë një faqe menaxhimi të karburanteve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nepermjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targon e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar levizjen e mundshme të targave nga mjetet shtetërorë drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të emailit për cdo furnizim të kryer të mjetit prane stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj .
- Disponimi/Ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (ëebpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kërkuara mesipër, do të demonstron nga ana e operatorëve ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktike, në prani anëtarëve të KVO-së së Autoritetit Kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mesipër në mënyrë elektronike nepermjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (ëebpage), që ofron cdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të

veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe në përcaktimet e bëra në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Për këtë qëllim është kërkuar që të paraqitet një deklaratë e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët duhet të ofrojnë furnizimin me karburant për mjetet e transportit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, gjë e cila garanton Autoritetin Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës, sipas kuadrit rregullator të përcaktuar në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Nëpërmjet këtij kriteri synohet gjithashtu, edhe evitimi i kostove të shtuara për Autoritetin Kontraktor, sa i përket kostos së prodhimit dhe pajisjes me karta elektronike të personalizuar, në funksion të zbatimit të kontratës.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë në tender dokument të lëshuar nga administrata tatimore, sipas legjislacionit në fuqi, ku të ketë minimalisht **15** punonjës të siguruar, për periudhën e **3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës** Për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim duhet të paraqitet vërtetim nga Tatimet dhe listëpagesat për të gjithë periudhën e kërkuar.

**Edhe në rast se ofertuesi do të konkuroj për dy ose tre lote, shuma e punonjësve për të gjitha lotet duhet të jetë minimalisht 15 punonjës”.*

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 5/c, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësinë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e Operatorëve Ekonomikë ofertues dhe shërben njëkohësisht si një garanci për Autoritetin Kontraktor, sa i përket kapaciteti të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën. Pra, nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantohet që operatori ekonomik disponon stafin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.12. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë-Analizë për produktin Gazoil (Diesel 10 ppm ULSD), S SH EN 590:2022 ose ekuivalente të lëshuar nga ISHTI, ose nga një laborator shqiptar i çertifikuar, ose i huaj (*n.q.s është laborator i huaj, duhet të përkthyer në shqip dhe të noterizuar*), që vërteton cilësinë e produktit objekt i këtij prokurimi, në pajtueshmëri me specifikimet teknike, e lëshuar brenda 60 ditëve nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.....

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 6, gërma "c", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike."

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përmbushin standartet teknike dhe autoriteti kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara.

Ky kriter është vendosur me qëllim konfirmimin e standarteve të përcaktuara në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 "Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel".

2.3.13 Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) person përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve, për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës dhe dokumenti që provon certifikimin e mësipërm, i cili duhet të jetë lëshuar nga institucione shetërore ose shoqëri të akredituara dhe të njohura nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente, si dhe të figurojë në listpagesa.

**Ne rast se konkurohet për dy ose tre lote se bashku, kjo pikë plotësohet edhe me paraqitjen e një punonjësi të tillë.*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.13, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 5, gërma "b", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që aktiviteti të kryhet brenda kushteve të duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve.

Për sa më lart, punonjësi i cili duhet të jete të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të

cënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë aktivitetin sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.14 Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) punonjës përgjegjës për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës dhe dokumenti që provon certifikimin e mësipërm, i cili duhet të jetë lëshuar nga institucione shetërore ose shoqëri të akredituara dhe të njohura nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente, si dhe të figurojë në listpagesa.

**Në rast se konkurohet për dy ose tre lote se bashku, kjo pikë plotësohet edhe me paraqitjen e një punonjësi të tillë.*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për kriterin percaktuar sipas pikës 2.3.14, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Ky kriter është vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” si dhe në mbështetje të VKM Nr.1047, datë 16.7.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.170, datë 25.4.2002 të këshillit të ministrave “për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve, për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”. Njësia e prokurimit gjykon se me qëllim garantimin e sigurisë dhe referuar standarteve ligjore në fuqi operatori ekonomik duhet të ketë një punonjës ekspert zjarrëfikës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikullin e kërkuar karburant (dizel), përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

*Të dhënat teknike të naftës i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar **SSH EN 590:2022**, “Lëndë djegëse e lëngët për automjete -Gazoil (Diesel)”, të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit në VKM-në nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse Benzinë dhe Dizel”.*

Disa nga specifikimet baze duhet të jene si ne tabelen me poshte:

Specifikime Teknike				
Nr.	Treguesit	Njësia e matjes	Kufijtë e lejuar	
1	Numri i cetanit		51.0	-
2	Indeksi i cetanit		46	-
3	Densiteti në 15°C	Kg/m ³	820	845
4	Hidrokarburet aromatikë policiklike	% (m/m)	-	8
5	Përmbajtja e sqfurit	mg/kg	-	10
6	Pika e flakërimit	°C	55	-
7	Graviteti API	Llogaritje		
8	Permbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010
9	Pika e bllokimit të filtrit CFPP	°C	-	-
10	Korrozioni në shufër bakri (3 orë në 50 °C)	vlerësim	Klasa 1	
11	Përmbajtja e esterit metalik të acidit yndyror (FAME)	% v/v	-	7
12	Viskoziteti në 40°C	mm ² /s	2.00	4.50
13	Përmbajtja e ujit	% (m/m)	-	0.020
14	Lubriciteti, në 60 °C	µm	-	460
15	Pika e turbullimit	°C	-	-
16	Mbetje karboni (në 10% mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0.3
17	Distilimi:			
	Distilati që vlon deri në 250 °C, % (v/v)	% v/v		65
	Distilati që vlon deri në 350 °C, % (v/v)	% v/v	85	
	95 % (v/v) distilon në	°C		360

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Furnizimi do të realizohet në distributor nëpërmjet kartave elektronike.

Kostoja për pajisjen me karta elektronike duhet të përballohet nga kontraktuesi.

Operatori ekonomik fitues bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, në përfundim të procedurave të prokurimit do të marrë një listë të mjeteve të Autoriteteteve Kontraktore përkatëse me qëllim pajisjen e tyre me kartë elektronike të personalizuar, sipas kërkesave për limitin mujor të tyre.

Kartat elektronike duhet të jenë të vlefshme dhe të përdorshme deri në ekzekutimin e plotë të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes kuader.

Kontraktuesi duhet të marrë përsipër ofrimin e furnizimit me karburant 24 orë në çdo ditë të javës.

Furnizimi me karburant do të bëhet sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në

kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Loti II. “Blerje Benzine”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës 353.384,08 (treqind e pesëdhjetë e tremijë e treqind e tetëdhjetë e katër presje zero tetë) lekë ose 3428,58 (tremijë e katërqind e njëzet e tetë presje pesëdhjetë e tetë) euro, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit3. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 9001:2015 (e vlefshme) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e cila të përfshijë objektin e prokurimit. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.).

2.1.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 14001 (e vlefshme) mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” e cila të përfshijë objektin e prokurimit. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti

kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkohet vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, në një vlerë jo më të vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të këtij loti, referuar nenin 43 pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi kjo është një procedurë e Hapur- mbi kufirin e lartë monetar, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c" të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

Shënim:

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare, sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Përcaktimi sa më sipër bëhet në mbështetje të nenit 42, Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti** dhe konkretisht jo më të vogël se vlera: **7.067.681 (shtatë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa tvsh ose jo më e vogël se 68.571 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një) euro pa tvsh**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

c. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Në rast se operatori ekonomik ofertues merr pjesë në dy ose tre lote së bashku, vlera e furnizimeve të ngjashme, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e shumës së loteve ku oferton, të marra së bashku.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me

qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Subjekti ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në Bashkinë Tiranë. Subjekti duhet të ketë minimalisht 7 stacione të shitjes me pakicë të karburanteve, vërtetuar me dokumentacionin: **(a)** Certifikatë pronësie/kontratë noteriale qiraje ose huaje të ambientit, **(b)** Ekstrakt e QKB-së ku të jenë pasqyruar stacionet e furnizimit, **(c)** Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK); Certificate e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH; Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, per distributoret e shitje me pakice, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave.

Operatori ekonomik duhet të paraqes listen e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas tabelës me poshtëme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1			

**Edhe në rast se ofertuesi do të konkuroj për dy ose tre lote, për të gjitha lotet duhet të ketë minimalisht 7 stacione”.*

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40,pika 5/a/ç dhe pika 8, ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Ky kriter është vendosur për të evituar kosto të shtuara për Autoritetin Kontraktor në lidhje me procesin e furnizimit të automjeteve me karburant dhe për këtë arsye janë kërkuar 7 stacione për shitjen e karburantit brenda Bashkisë Tiranë të cilat janë të domosdoshme referuar dhe objekteve në administrim të APR-së e cila ka një shtrirje të gjërë brenda Bashkisë së Tiranës ku Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave ka 13 njësi administrative, të cilat zënë pjesën më të madhe të fondit pyjor, dhe shtrihen deri në kufi me Bashkitë e tjera.

Nëpërmjet kërkesës për 7 stacione furnizimi, Autoriteti Kontraktor synon të ulë koston e furnizimit të automjeteve, sipas parimit të ekonomisë së kursimit, për shkak se automjetet lëvizin në zona të ndryshme të Bashkisë Tiranë dhe në rast se këto stacione do të ishin më larg, kjo do të ndikonte direkt në rritjen e koston, pasi mjetet do të harxhonin më tepër karburant për shkak të itinerarit që do të përshkojnë. Gjithashtu, nëpërmjet këtij kriteri, synohet edhe kursimi i kohës që do të duhet për të realizuar procesin e furnizimit në stacionet e karburantit.

2.3.3 Të gjitha stacionet e furnizimit me karburant detyrimisht duhet të mbajnë të njëjtën Logo, cka do jetë e vërtetuar me një deklaratë nga subjekti ofertues, ku të paraqitet dhe logo e shoqërisë e cila do të jetë në këto stacione. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve, stacionet e furnizimit duhet të përmbajnë Logo-të e shoqërive pjesë të bashkimit, cka do jetë e vërtetuar me një deklaratë nga shoqëritë përkatëse, ku të paraqitet dhe logo e tyre.

Argumentimi: Kriteri sa më sipër bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" si dhe referuar përcaktimeve të nenit 40, pika 8 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Gjithashtu kërkesa është vendosur në përputhje me Ligjin 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim teknik të leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK, Leje mjedisore të tipit B, të leshuar nga QKL, Akt-Teknik të leshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi të leshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregtimit me shumicë që vërteton kapacitetet depozituese lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktore.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 "Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel", VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie të licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 429, datë 26.6.2019 për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)", Urdhër Nr. 6, datë 09.01.2015 "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe Nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse, Urdhërit nr 315, datë 24.08.2017 "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimin të naftës dhe nënprodukteve të saj", Ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, "për lejet e Mjedisit", të ndryshuar

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 autobus të transportit të lëndëve të rrezikshme (benzinë), kapacitet mbajtës deri në 1,000 litra duhet të jenë për transport benzinë. Për të provuar disponimin e autobusit, Operatori ekonomik duhet të paraqesë për autobusin dokumentacionin që përbëhet nga: **(a)** Leje qarkullimi, **(b)** Certifikatën e kontrollit teknik, **(c)** Policë sigurimi, **(d)** Certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, **(dh)** Pasaportën e mjetit lidhur me kapacitetin mbajtës. Autobosi duhet të jetë i kalibruar nga DPM.

**Në rast se konkurohet për lotet Naftë dhe Benzinë së bashku, shuma e autoboteve që duhet të disponoj Operatori ekonomik duhet të jetë në total 2 copë.*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, sipas kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.5, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur mbi kufirin e latrë monetar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 5/ç ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit ”mallra” duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të automjetetit për transportin e karburantit, por pa përcaktuar se si disponohen këto automjete dhe meqënëse këto mjete qarkullojnë në territorin shqiptar, ju referuam nenit 81, 83 e 178 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 ”Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2.3.6 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të leshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësive përgjatë vitit të fundit 2023.

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës” si dhe Ligjit 10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Shtrirja kohore ka të bëjë me faktin e kualifikimit të OE të cilët operojnë në treg me një performancë të mirë në funksion të mbajtjes së cilësisë sipas standarteve zyrtare të kërkuara për mallin objekt kontrate për një shtrirje kohore 1 vit.*

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçencë VIII.1.A për tregtim karburantesh të llojit II/A (Benzine automjetesh) leshuar nga QKL (Qendra Kombëtare e Licensimit) ose Autorizim apo Licensë për tregtim karburantesh (Benzine automjetesh) për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqenëse objekti i prokurimit është blerja e karburantit të llojit: Benzinë për automjete e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve duhet të jenë të rregjistruar në një nga regjistrat profesionale për zbatimin e objektit të kontratës.

Gjithashtu në nenin 4 të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar përcaktohet se:

" Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë operatorët ekonomikë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e tregtimit të karguranteve janë të detyruar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë të rregjistruar në regjistrat përkatës.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar, ku në pikën I/2/a dhe në pikën II/1 përcaktohet se:

"I. PROCEDURA E DHËNIES SË LICENCAVE TË TREGTIMIT ME SHUMICË TË NAFTËS BRUTO DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ

1. Veprimtaria e tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj bëhet vetëm nga shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqërive aksionare, pasi të jenë pajisur me "Licencë tregtimi" nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

2. Licenca "Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse", me kodin VIII.1.A, përfshin tri llojet e veprimtarive, si më poshtë vijon:

a) Lloji "A": tregtimi me shumicë i naftës bruto e nënprodukteve të saj të kategorive 0, II, III, IV e V, me përjashtim të nënprodukteve që destinohen për furnizimin e mjeteve të fluturimit ajror;

II. PROCEDURA PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR TREGTIMIN ME PAKICË TË KARBURANTEVE, GAZIT TË LËNG-SHËM TË NAFTËS, PËR AUTOMJETET, VAJRAVE LUBRIFIKANTE DHE LËNDËVE DJEGËSE PËR PËRDORIM NGA KON-SUMATORËT FUNDORË

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

a) Ministri që mbulon veprimtarinë e transportit rrugor, kur stacioni i karburanteve do të ndërtohet në autostradë;

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.”.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, ku në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

”2. Në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet QKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;

b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;

c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;

ç) Afatet e vlefshmërisë së licencave;

d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e QKL-së;

dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet QKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;

e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që QKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;

ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;

f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;

g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.

Aneksi 1

FUSHA VIII

INDUSTRI DHE SHËRBIME TË TJERA

KATEGORIA VIII.1

PRODHIMI, DEPOZITIMI, TRANSPORTI, PËRDORIMI DHE/OSE TREGTIMI I
PRODUKTEVE DHE/OSE LENDEVE A PAJISJEVE TË TJERA ME RREZIKSHMËRI

1. Veprimtaritë e “Prodhimit, depozitimit, transportit, përdorimit dhe/ose tregtimit të produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri” bëjnë pjesë në kategorinë VIII.1 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”..

2. Kategoria e këtyre veprimtarive ndahet në tre nënkategori si vijon:

a) “Tregtimi me shumice i naftes, gazit, nenprodukteve perفشire ato bio si dhe lendet djegese” me kodin VIII.1.A

b) “Veprimtari të lidhura me substancat dhe preparatet kimike me rrezikshmeri” me kodin VIII.1.B

c) “Veprimtari të lidhura me burime me rrezatim jonizues” me kodin VIII.1.C

3. Tregtia me pakicë licencohet sipas legjislacionit në fuqi. Veprimtari të tjera specifike me këto lëndë nuk licencohen.

4. Kriteret e posaçme të licencimit si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për nënkategorinë VIII.1.A jepen në tabelën 1 më poshtë.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, gjykojmë se operatorët ekonomik ofertues të cilët tregtojnë karburante të llojit: Benzinë për automjete, duhet që të jenë të pajisur me licensë VIII.1.A për tregtim karburantesh të llojit II/A ose me licensë apo autorizim të tregtimit pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur– Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/a "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"5. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose;"

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me licensa profesionale për furnizimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin konkret meqënëse edhe ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar uk lejon që të ushtrohet aktiviteti i tregtimit të karburanteve pa licensë profesionale atëherë njësia e prokurimit vendosi hartimin dhe vendosjen e këtij kriteri kualifikues

2.3.8 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me karte elektronike te personalizuar me targon e cdo automjeti te autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasine e litrave te ndodhura ne karten elektronike te personalizuar me targon e mjetit, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Kartat elektronike duhet të jenë pa afat skadencë.
- Operatori ekonomik duhet te mbuloje furnizimin nepermjet karteve elektronike te personalizuar, sipas nevojës të Autoritetit Kontraktor.Kartat elektronike te jenë pa skadencë gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër.
- Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 "**Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem**", Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepermjet kartes elektronike.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit te sasisë se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit, si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet te ofroje edhe mundesine e afishimit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.

- Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit Kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar levizjen e mundshme të targave nga mjetit shtetëror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të emailit për çdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj .
- Disponimi/Ëkzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (ëebpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kërkuara mesipër, do të demonstrohen nga ana e operatoreve ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktike, në prani anëtarëve të KVO-së së Autoritetit Kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mesipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (ëebpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe në përcaktimet e bëra në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Për këtë qëllim është kërkuar që të paraqitet një deklaratë e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët duhet të ofrojnë furnizimin me karburant për mjetet e transportit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, gjë e cila garanton Autoritetin Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës, sipas kuadrit rregullator të përcaktuar në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Nëpërmjet këtij kriteri synohet gjithashtu, edhe evitimi i kostove të shtuara për Autoritetin Kontraktor, sa i përket kostos së prodhimit dhe pajisjes me karta elektronike të personalizuar, në funksion të zbatimit të kontratës.

2.3.11. Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë në tender dokument të lëshuar nga administrata tatimore, sipas legjislacionit në fuqi, ku të ketë minimalisht **15** punonjës të siguruar, për periudhën e **3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës** Për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim duhet të paraqitet vërtetim nga Tatimet dhe listëpagesat për të gjithë periudhën e kërkuar.

**Edhe në rast se ofertuesi do të konkuroj për dy ose tre lote, shuma e punonjësve për të gjitha lotet duhet të jetë minimalisht 15 punonjës”.*

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 5/c, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësinë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e Operatorëve Ekonomikë ofertues dhe shërben njëkohësisht si një garanci për Autoritetin Kontraktor, sa i përket kapaciteti te operatorit ekonomik per te realizuar kontraten. Pra, nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantohet që operatori ekonomik disponon stafin e nevojshem per realizimin me sukses te kontrates.

2.3.12. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë-Analizë për produktin Benzine pa plumb SSH EN 228:2012+A1:2017 ose ekuivalente të lëshuar nga ISHTI, ose nga një laborator shqiptar i çertifikuar/autorizuar/akredituar, ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj, duhet e përkthyer në shqip dhe e noterizuar), që vërteton cilësinë e produktit objekt i këtij prokurimi, në pajtueshmëri me specifikimet teknike, e lëshuar brenda 60 ditëve nga data e hapjes së ofertave. Në analizë të jenë të përcaktuara qartësisht të gjitha të dhënat e këtij artikulli , me qëllim krahasimin e tij me specifikimet teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.....

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 6, gërma ”c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përmbushin standartet teknike dhe autoriteti kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara.

Ky kriter është vendosur me qëllim konfirmimin e standarteve të përcaktuara në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”.

2.3.13. Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) person përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve, për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës dhe dokumenti që provon certifikimin e mësipërm, i cili duhet të jetë lëshuar nga institucione shetërore

ose shoqëri të akredituara dhe të njohura nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente, si dhe të figurojë në listpagesa.

**Në rast se konkurohet për dy ose tre lote se bashku, kjo pikë plotësohet edhe me paraqitjen e një punonjësi të tillë.*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për plotësimin e kriterit përcaktuar sipas pikës 2.2.13, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 5, gërma “b”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që aktiviteti të kryhet brenda kushteve të duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve.

Për sa më lart, punonjesi i cili duhet të jete të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë aktivitetin sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.14. Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) punonjës përgjegjës për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës dhe dokumenti që provon certifikimin e mësipërm, i cili duhet të jetë lëshuar nga institucione shetërore ose shoqëri të akredituara dhe të njohura nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente, si dhe të figurojë në listpagesa.

**Në rast se konkurohet për dy ose tre lote se bashku, kjo pikë plotësohet edhe me paraqitjen e një punonjësi të tillë.*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, , për plotësimin e kriterit përcaktuar sipas pikës 2.2.14, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Ky kriter është vendosur ne mbeshtetje te Ligjit nr. 152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” si dhe në mbështetje të VKM Nr.1047, datë 16.7.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.170, datë 25.4.2002 të këshillit të ministrave “për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve, për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”. Njësia e prokurimit gjykon se me qëllim garantimin e sigurisë dhe referuar standarteve ligjore ne fuqi operatori ekonomik duhet të këtë një punonjës ekspert zjarrëfikës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikullin e kërkuar karburant (Benzinë pa plumb), përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Të dhënat teknike të naftës i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar SSH EN 228:2012+A1:2017, “Lëndë djegëse për automjete-Benzinë pa plumb“, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit, dhe të përcaktuara në VKM-në nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse Benzinë dhe Diezel“.

Benzine Pa Plumb ne perputhje me standardin shtetror S.SH.EN 228:2012+A1:2017

Specifikime Teknike				
Nr.	Treguesit	Njësia e matjes	Kufijtë e lejuar	
1	Numri Oktanit Kerkimor		95	-
2	Numri i Oktanit Motorrik		85	-
3	Densiteti në 15 °C	Kg/m³	720	775
4	Përmbajtja e Squfurit	mg/kg	-	10
5	Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë/50 °C)	Renditje	Klasa 1	
6	Graviteti API	Llogaritje		
7	Tensioni I avujve te thate ekuivalent (DVPE)	kPa	45	100
8	Distilimi			
a	Distilon deri 70 °C	% (v/v)	20	48
b	Distilon deri 100 °C	% (v/v)	46	71
c	Distilon deri 150 °C	% (v/v)	75	-
d	Pika Finale e Distilimit	°C	-	210
e	Mbetjet e Distilimit	% (v/v)	-	2
9	Përmbajtja e tipit të hidrokarburit			
a	Olefinat	% (v/v)	-	18

b	Aromatiket	% (v/v)	-	35
10	Përmbajtja e benzenit	% (v/v)	-	1
11	Përmbajtja e oksigjenit	% (m/m)	-	2.7
12	Përmbajtja e komponimeve oksigjenore			
a	Methanol (alkool metilik)	% (v/v)	-	3
b	Etanol (alkool etilik)			5
c	- Alkool izopropilik - Alkool izo butilik - Alkool terc butil - Etere (me 5 ose më shumë atome C) - Komponime oksigjenore të tjera		}	Përzierja në vëllim i kufizuar në 2.7% (m/m) të përmbajtjes maksimale të oksigjenit

Furnizimi do të realizohet në distributor nëpërmjet kartave elektronike.

Kostoja për pajisjen me karta elektronike duhet të përballohet nga kontraktuesi.

Operatori ekonomik fitues bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, në përfundim të procedurave të prokurimit do të marrë një listë të mjeteve të Autoriteteteve Kontraktore përkatëse me qëllim pajisjen e tyre me kartë elektronike të personalizuar, sipas kërkesave për limitin mujor të tyre.

Kartat elektronike duhet të jenë të vlefshme dhe të përdorshme deri në ekzekutimin e plotë të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes kuader.

Kontraktuesi duhet të marrë përsipër ofrimin e furnizimit me karburant 24 orë në çdo ditë të javës.

Furnizimi me karburant do të bëhet sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Loti III. “Blerje Gaz”

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës 27.571,2 (njëzet e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një presje dy) lekë ose 267.49 (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë presje dyzet e nëntë) euro, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit3. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikaten ISO 9001:2015 (e vlefshme) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e cila të përfshijë objektin e prokurimit. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

2.1.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikaten ISO 14001(e vlefshme) mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” e cila të përfshijë objektin e prokurimit. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit**

limit të këtij loti dhe konkretisht jo më të vogël se vlera: **551.424 (pesëqind e njëzet e njëmijë e katërqind e njëzet e katër) lekë pa tvsh ose 5349 (pesëmijë e treqind e dyzet e nëntë) euro pa tvsh.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Kërkohet vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, në një vlerë jo më të vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të këtij loti, referuar nenin 43 pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi kjo është një procedurë e **Hapur- mbi kufirin e lartë monetar**, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c” të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

Shënim:

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare, sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Përcaktimi sa më sipër bëhet në mbështetje të nenit 42, Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti** dhe konkretisht jo më të vogël se vlera: **551.424 (pesëqind e njëzet e njëmijë e katërqind e njëzet e katër) lekë pa tvsh ose 5294,51 (pesëmijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër presje pesëdhjetë e një) euro pa tvsh**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Në rast se operatori ekonomik ofertues merr pjesë në dy ose tre lote së bashku, vlera e furnizimeve të ngjashme, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e shumës së loteve ku oferton, të marra së bashku.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Subjekti ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në Bashkinë Tiranë. Subjekti duhet të ketë minimalisht 7 stacione të shitjes me pakicë të karburanteve, vërtetuar me dokumentacionin: (a) Certifikatë pronësie/kontratë noteriale qiraje ose huaje të ambientit, (b) Ekstrakt e QKB-së ku të jenë pasqyruar stacionet e furnizimit, (c) Vertetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK); Certifikate e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH; Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne

ne Shqiperi, per distributoret e shitje me pakice, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave.

Operatori ekonomik duhet te paraqes listen e detajuar te stacioneve te shitjes se karburanteve me pakice sipas tabelës me poshtëme me te dhenat perkatëse:

Tabela nr. 1:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1			

**Edhe në rast se ofertuesi do të konkuroj për dy ose tre lote, për të gjitha lotet duhet të ketë minimalisht 7 stacione”.*

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40,pika 5/a/ç dhe pika 8, ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Ky kriter është vendosur për të evituar kosto të shtuara për Autoritetin Kontraktor në lidhje me procesin e furnizimit të automjeteve me karburant dhe për këtë arsye janë kërkuar 7 stacione për shitjen e karburantit brenda Bashkisë Tiranë të cilat janë të domosdoshme referuar dhe objekteve në administrim të APR-së e cila ka një shtrirje të gjërë brenda Bashkisë së Tiranës ku Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave ka 13 njësi administrative, të cilat zënë pjesën më të madhe të fondit pyjor, të cilat shtrihen deri në kufi me Bashkitë e tjera.

Nëpërmjet kërkesës për 7 stacione furnizimi, Autoriteti Kontraktor synon të ulë koston e furnizimit të automjeteve, sipas parimit të ekonomisë së kursimit, për shkak se automjetet lëvizin në zona të ndryshme të Bashkisë Tiranë dhe në rast se këto stacione do të ishin më larg, kjo do të ndikonte direkt në rritjen e koston, pasi mjetet do të harxhonin më tepër karburant për shkak të itinerarit që do të përshkojnë. Gjithashtu, nëpërmjet këtij kriteri, synohet edhe kursimi i kohës që do të duhet për të realizuar procesin e furnizimit në stacionet e karburantit.

2.3.3 Të gjitha stacionet e furnizimit me karburant detyrimisht duhet të mbajnë të njëjtën Logo, cka do jetë e vërtetuar me një deklaratë nga subjekti ofertues, ku të paraqitet dhe logo e shoqërisë e cila do të jetë në këto stacione. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve, stacionet e furnizimit duhet të përmbajnë Logo-të e shoqërive pjesë të bashkimit, cka do jetë e vërtetuar me një deklaratë nga shoqëritë përkatëse, ku të paraqitet dhe logo e tyre.

Argumentimi: Kriteri sa mësipër bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Per prokurimin publik” si dhe referuar përcaktimeve të nenit 40, pika 8 ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.Gjithashtu kërkesa është vendosur në përputhje me Ligjin 8450, datë 24.2.1999 ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësive përgjatë vitit të fundit 2023.

(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej tyre duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI që vërteton se subjekti ofertues, nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësive për vitin 2023).

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës” si dhe Ligjit 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Shtrirja kohore ka të bëjë me faktin e kualifikimit të OE të cilët operojnë në treg me një performancë të mirë në funksion të mbajtjes së cilësive sipas standarteve zyrtare të kërkuara për mallin objekt kontrate për një shtrirje kohore 1 vit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 autobus për transport GLN.

Për të provuar disponimin e autobusit, Operatori ekonomik duhet të paraqesë për autobusin dokumentacionin që përbëhet nga: **(a)** Leje qarkullimi, **(b)** Certifikatën e kontrollit teknik, **(c)** Policë sigurimi, **(d)** Certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, **(dh)** Pasaportën e mjetit lidhur me kapacitetin mbajtës.

**Në rast se konkurohet për 3 lotet së bashku, shuma e autoboteve që duhet të disponoj Operatori ekonomik duhet të jetë në total 3 copë referuar specifikave për secilin lot.*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësive. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë

një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 5/ç ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit ”mallra” duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të automjetetit për transportin e karburantit, por pa përcaktuar se si disponohen këto automjete dhe meqënëse këto mjete qarkullojnë në territorin shqiptar, ju referuam nenit 81, 83 e 178 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 ”Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2.3.6 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me karte elektronike të personalizuar me targon e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasine e litrave të ndodhura në karten elektronike të personalizuar me targon e mjetit, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Kartat elektronike duhet të jenë pa afat skadencë.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepermjet karteve elektronike të personalizuar, sipas nevojës të Autoritetit Kontraktor. Kartat elektronike të jenë pa skadencë gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër.
- Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 **“Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme”**, Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nepermjet kartes elektronike.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targon e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukture piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar levizjen e mundshme të targave nga mjetit shtetëror drejt

mjeteve private, si dhe sherbimin e dergimit te fotografive me ane te emailit per cdo furnizim te kryer te mjetit prane stacionit te shitjes se karburanteve me pakice me qellim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj .

- Disponimi/Ekzistenca e faqes se menaxhimit te karburanteve (ëebpage), se bashku me ofrimin sherbimeve te kerkuara mesiper, do te demostrohen nga ana e operatoreve ekonomik pjesemarres me shembuj per zbatimin ne praktike, ne prani anetareve te KVO-se se Autoritetit Kontraktor perpara mbylljes se procesit te kualifikimit dhe shpalljes se fituesit.
- Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara mesiper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (ëebpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarres perben kusht per skualifikim.

***Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe në përcaktimet e bëra në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Për këtë qëllim është kërkuar që të paraqitet një deklaratë e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët duhet të ofrojnë furnizimin me karburant për mjetet e transportit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, gjë e cila garanton Autoritetin Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës, sipas kuadrit rregullator të përcaktuar në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Nëpërmjet këtij kriteri synohet gjithashtu, edhe evitimi i kostove të shtuara për Autoritetin Kontraktor, sa i përket kostos së prodhimit dhe pajisjes me karta elektronike të personalizuar, në funksion të zbatimit të kontratës.*

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë në tender dokument të lëshuar nga administrata tatimore, sipas legjislacionit në fuqi, ku të ketë minimalisht **15** punonjës të siguruar, për periudhën e **3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës** Për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim duhet të paraqitet vërtetim nga Tatimet dhe listëpagesat për të gjithë periudhën e kërkuar.

**Edhe në rast se ofertuesi do të konkuroj për dy ose tre lote, shuma e punonjësve për të gjitha lotet duhet të jetë minimalisht 15 punonjës”.*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

***Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 5/c, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësinë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e Operatorëve Ekonomikë ofertues dhe

shërben njëkohësisht si një garanci për Autoritetin Kontraktor, sa i përket kapaciteti të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën. Pra, nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantohet që operatori ekonomik disponon stafin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë në tender akt miratimit të projektit teknologjik për GLN, të shoqëruar detyrimisht me relacionin për aktin teknik të montimit, për instalimin e pajisjes nën presion dhe linjave të gazit, si dhe të ketë e shoqëruar me librin e pajisjes që punon nën presion, lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial, dhe Certifikata e inspektimit të konformitetit të rezervuarit stacionar.

Argumentim: *Kërkesa që OE duhet të paraqesë dokument “Akt miratimit të projektit teknologjik për GLN” të lëshuar nga një organ i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit është vendosur në zbatim të kërkesave që përcaktohen në Ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve nën presion”, Neni 4, Pika 3; 4; 5 ku përcaktohet:*

Pika 3. Përpara fillimit të procedurës së montimit të pajisjes/instalimit nën presion, operatorët ekonomikë marrin masa për vlerësimin e konformitetit të tij, nga një organ i miratuar/notifikuar për vlerësimin e konformitetit, në përputhje me rregullat teknike përkatëse.

Pika 4. Organi i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit shqyrton përputhshmërinë e projektit të paraqitur me rregullat teknike përkatëse dhe, nëse e gjen në përputhje me to, lëshon vërtetimin e përputhshmërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Pika 5. Inspektorati shtetëror përgjegjës mbikëqyr zbatimin e këtij detyrimi nga operatorët ekonomikë përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

2.3.11. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë-Analizë për produktin Gaz **SSH EN SSH EN 589:2018** ose ekuivalente të lëshuar nga ISHTI, ose nga një laborator shqiptar i çertifikuar/autorizuar/akredituar, ose i huaj (*n.q.s është laborator i huaj, duhet e përkthyer në shqip dhe e noterizuar*), që vërteton cilësinë e produktit objekt i këtij prokurimi, në pajtueshmëri me specifikimet teknike, e lëshuar brenda 60 ditëve nga data e hapjes së ofertave. Në analizë të jenë të përcaktuara qartësisht të gjitha të dhënat e këtij artikulli, me qëllim krahasimin e tij me specifikimet teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.....

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 6, gërma “c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

*“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përmbushin standartet teknike dhe autoriteti kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Ky kriter është vendosur me qëllim konfirmimin e standarteve të përcaktuara në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”.

2.3.12. Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) person përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve, për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës dhe dokumenti që provon certifikimin e mësipërm, i cili duhet të jetë lëshuar nga institucione shetërore ose shoqëri të akredituara dhe të njohura nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente, si dhe të figurojë në listpagesa.

**Ne rast se konkurohet për dy ose tre lote së bashku, kjo pikë plotësohet edhe me paraqitjen e një punonjësi të tillë.*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 5, gërma “b”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që aktiviteti të kryhet brenda kushteve të duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve.

Për sa më lart, punonjësi i cili duhet të jetë i certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë aktivitetin sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.13. Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) punonjës përgjegjës për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës dhe dokumenti që provon certifikimin e mësipërm, i cili duhet të jetë lëshuar nga institucione shetërore

ose shoqëri të akredituara dhe të njohura nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente, si dhe të figurojë në listpagesa.

**Në rast se konkurohet për dy ose tre lote se bashku, kjo pikë plotësohet edhe me paraqitjen e një punonjësi të tillë.*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Ky kriter është vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” si dhe në mbështetje të VKM Nr.1047, datë 16.7.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.170, datë 25.4.2002 të këshillit të ministrave “për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve, për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”,. Njësia e prokurimit gjykon se me qëllim garantimin e sigurisë dhe referuar standarteve ligjore në fuqi operatori ekonomik duhet të ketë një punonjës ekspert zjarrëfikës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikullin e kërkuar karburant (Gaz), përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Të dhënat teknike të Gazit i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar SSH EN 589:2018, “Lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial-GLN (Mishelë)”, ose SSH ISO 9162:2013 “Gaze të lëngët nga nafta” të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe të përcaktuara në VKM-në nr. 429, datë 26.06.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujqor (Detar, Lumor, Liqenor)

